- **3.000.000 euro** (184.516.500,00 në kundërvlerë denari) nga shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të investimeve të cilat janë dedikuar për vendosjen e kapaciteteve të reja për thertore për shpezë plotësisht të përputhura me standardet e Bashkësisë Evropiane.

Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për ko-financim të një shfrytëzuesi nuk mund të tejkalojë 1.100.000 euro në kuadër të periudhës financiare 2007-2013.

Një shfrytëzues mund të dorëzojë më shumë kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve prej IPARD Programit 2007-2013, me kusht që të mos e kalojë vlerën maksimale të shpenzimeve të pranueshme për financim dhe nëse projektet e mëparshme janë të përfunduar me sukses, gjegjësisht përkrahja



	financiare është plotësisht e paguar.
5.	Lënda dhe kushtet për shfrytëzimin e përkrahjes financiare për masën 302
	Përkrahja financiare për masën 302 është dedikuar për popullatën rurale për investime në sektorët me prioritet: përkrahje të mikro ndërmarrjeve në mjediset rurale (3021) dhe investime për promovimin e aktiviteteve për turizmit rural (3022). Investimet patjetër të realizohen në mjediset rurale (të shënuara në Bashkëngjitje 11: Lista e rrethinave rurale në Republikën e Maqedonisë nga Udhëzuesi për shfrytëzues të mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013). Grupet e investimeve të sektorëve me prioritet u dedikohen llojeve të investimeve në vijim:
shifra	Lloji i investimit
30211	Investim për vendosjen e kapaciteteve përpunuese të ekonomive bujqësore dhe jashtë ekonomive bujqësore
30212	Investim për vendosjen dhe modernizimin e qendrave blerëse për kërpudha dhe bimë shëruese/aromatike dhe bimë për erëza, dhe kapacitete për kultivimin e kërpudhave
30213	Investim për vendosjen e punëtorive të veprimtarive të zejeve tradicionale dhe punëtori për mirëmbajtjen e mekanizmit bujqësor
30221	Investim për rikonstruimin e objekteve të ekonomive bujqësore të dedikuara për turizëm rural, dhe të plotësuara me kapacitete rekreative
30222	Investime për ndërtimin e objekteve hotelierike, vendosje në ambient të hapur (kampe) dhe kapacitete rekreative
5.1.	<p>Kërkues për shfrytëzim të mjeteve nga Masa 302 mund të jenë:</p> <p>a) Për vendosjen e kapaciteteve përpunuese të ekonomisë bujqësore - ekonomi bujqësore të cilët janë të regjistruar në Regjistrin e vetëm për ekonomi bujqësore në MBPE në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gaz. zyrtare e RM" nr. 134/2007, 49/10),</p> <p>b) Për vendosjen e kapaciteteve përpunuese jashtë ekonomisë bujqësore- persona juridik të cilët janë themeluar në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare ("Gaz. Zyrtare e RM" nr. 28/04, 84/05, 25/07, 87/08, 42/10, 48/10) dhe janë të regjistruar në Regjistrin qendror tregtar individual apo shoqëri tregtare në rangun e mikro tregtarit; apo si zejtarë në pajtim me Ligjin për veprimtari të zejtarisë ("Gaz. Zyrtare e RM" nr. 62/04, 55/07, 115/10) dhe të regjistruar në Odën e zejtarëve për kryerje të veprimtarisë- prodhim i ushqimit- në pajtim me Listën e veprimtarive përmunuese dhe aktiviteteve prodhuese nga Bashkëngjitja ^ nga Udhëzuesi për shfrytëzuesit e mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013.</p> <p>c) Për vendosje dhe modernizim të qendrave mbledhëse për kepurdha dhe bimë medicinale/aromatike/erëza të cilat janë të themeluara në pajtim me Ligjin për Kooperativa (Gaz. Zyrtare e RM" nr 54/02, 84/05) dhe janë të regjistruar në Regjistrin qendror.</p> <p>ç) për vendosjen e punëtorive të veprimtarive të zejeve tradicionale⁵ dhe punëtori për mirëmbajtjen e mekanizmit bujqësor:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ekonomi bujqësore – të cilët janë të regjistruar në Regjistrin qendror të ekonomive bujqësore në MBPE në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gaz. Zyrtare e RM." Nr. 134/2007, 49/10), - zejtarë – në pajtim me Ligjin për veprimtari të zejtarisë ("Gaz. Zyrtare e RM" nr. 62/04, 55/07, 115/10), dhe të regjistruar në Odën e zejtarëve për kryerje të veprimtarisë përkatëse - persona juridik – të cilët janë të themeluar në pajtim me Ligjin për shoqëri tregtare ("Gaz. Zyrtare e RM" nr. 28/04, 84/05, 25/07, 87/08, 42/10, 48/10) dhe janë të regjistruar në Regjistrin qendror si tregtarë individual apo shoqëri tregtare në rangun e mikro tregtarit për kryerje të veprimtarisë përkatëse zejtare. <p>Vërejtje⁵: Lista e veprimtarive të zejeve tradicionale është i shënuar në Bashkëngjitje 7 nga Udhëzuesi për shfrytëzues të mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013.</p> <p>d) për aktivitete në turizmin rural- pronarë apo shfrytëzues të objekteve të vjetra tradicionale, pronarë/koncesioner të fushave me peshq apo koncesioner të ujërave për peshkim sportiv apo pronarë të pyjeve private, të cilët janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - ekonomi bujqësore- të cilët janë të regjistruar në Regjistrin qendror të ekonomive bujqësore në MBPE në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gaz. Zyrtare e RM" nr. 134/2007, 49/10), - persona juridik – të cilët janë të themeluar në pajtim me ligjin për shoqëri tregtare ("Gaz. Zyrtare e RM"



	<p>nr. 28/04, 84/05, 25/07, 87/08, 42/10, 48/10) dhe janë të regjistruar në Regjistrin qendror si tregtar individual apo shoqëri tregtare në rangun e mikro tregtarit,</p> <ul style="list-style-type: none"> - zejtarë – në pajtim me ligjin për veprimtari të zejtarisë (“Gaz. Zyrtare e RM” nr. 62/04, 55/07, 115/10), dhe të regjistruar në Odën e zejtarëve). <p>2) Madhësia e kapaciteteve prodhuese</p> <p>Madhësia e kapaciteteve prodhuese për investime për vendosjen e kapaciteteve përpunuese të ekonomive bujqësore dhe jashtë ekonomive bujqësore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - për përpunimin e pemëve dhe perimeve, kërkuesi duhet të posedojë ose të marrë me qira minimum 0,5 ha hapësirë me pemë ose perime;⁶ - për përpunimin e qumështit, kërkuesi duhet të posedojë së paku 10 lopë për mjelje ose 150 dhen për mjelje ose 50 dhi për mjelje;⁶ - për prodhimin dhe shitjen e mjaltit, kërkuesi duhet të posedojë së paku 30 familje bletësh;⁶ - për përpunimin e bimëve shëruese/aromatike dhe erëzave, kërkuesi duhet të posedojë ose huazojë së paku 0,75 ha tokë për bimë shëruese/aromatike dhe erëza të përmbajtura në Listën për bimë shëruese/aromatike dhe erëza në Pjesën 5 të Udhëzimit për përdoruesit e mjeteve sipas IPARD Programit 2007-2013 - për përpunim dhe shitje të kërpudhave, kërkuesi duhet të posedojë minimum 30m² për kultivimin e kërpudhave. - Përderisa kërkuesi investon në rikonstruimin e objekteve të turizmit rural të ekonomisë bujqësore vreshtare dhe/ose bodrumeve të verës për turizëm rural të përmbushura me kapacitete rekreative, kërkuesi duhet të ketë kapacitet të prodhimit minimal vjetor të ngjashëm me 20hl dhe kapacitet maksimal vjetor të prodhimit të barabartë me 400hl. <p>Vërejtje⁶: Përderisa kërkuesi nuk e plotëson madhësinë e kërkuar të kapaciteteve prodhuese duhet të parashtrojë kontratat e lidhura (për periudhë më së paku për një vit) me prodhues lokal të lëndës së parë për kryerjen e veprimtarisë për përpunim</p> <p>3) Kërkuesit duhet të dëshmojnë shkallë përkatëse të arsimit të mbaruar profesional gjegjësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në pajtueshmëri me Rregulloren për mënyrën e kontrollimit të njohurive dhe mënyrën e dhënies së vërtetimeve për arritje të njohurive fillestare për higjienë të ushqimit dhe mbrojtje të ambientit jetësor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 118/05) - Në pajtueshmëri me Ligjin për arsim profesional dhe trajnim (Gazeta Zyrtare e RM nr. 71/2006, 117/2008, 148/09), certifikata mund të merret në institucionet për arsim dhe përgatitje profesionale (shkolla për arsim profesional dhe qendra për përgatitje profesionale); - Zejtarët mund të kryejnë aktivitete zejtarie përderisa posedojnë arsim profesional përkatës ose aftësi profesionale përkatëse për kryerjen e aktiviteteve të caktuara zejtare. - Personi përgjegjës për subjektin ligjor nuk mund të jetë më i vjetër se 59 vjet për meshkujt dhe 57 vjet për femrat, duke e marrë parasysh kufirin e moshës për pensionim prej 64 vjetëve për meshkujt dhe 62 vjetëve për femrat në pajtueshmëri me urdhrat nga Ligji për sigurim pensional dhe invalidor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 80/93, 14/95, 71/96, 32/97, 24/00, 96/00, 5/01, 85/03, 50/04, 4/05, 84/05, 101/05, 70/06, 153/07, 152/08, 161/08, 81/09, 156/09, 83/10) - Personi përgjegjës në subjektin ligjor duhet të jetë në marrëdhënie të rregullt pune.
5.2.	<p>Lartësia e financimit sipas masës 302</p> <p>Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme është 5 000 euro (307.527.50 në kundërvlerë denarë)</p> <p>Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme nuk duhet të tejkalojë shumën prej 200.000 euro (12.301.200,00 në kundërvlerë denarë)</p> <p>Kufizime të tjera financiare të cilat aplikohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> – Shpenzimet e pranueshme të përgjithshme të aktiviteteve turistike (vende për shitje, hapësira për



	<p>degustim të verës dhe kapacitete rekreative) nuk duhet të tejkalojnë mbi 25% nga shpenzimet e pranueshme të përgjithshme të investimeve (në përjashtim të gjithsej shpenzimeve të pranueshme të përgjithshme) të parapara në kornizën e buxhetit të projektit, përderisa projekti në tërësi ka për qëllim rikonstruimin e objekteve të ekonomisë bujqësore të dedikuara për turizëm rural;</p> <p>Shuma e përgjithshme maksimale e shpenzimeve të pranueshme për ko-financim të një shfrytëzuesi nuk duhet të jetë mbi 250 000 euro në kuadër të periudhës financuese 2007-2013.</p> <p>Një shfrytëzues mund të dorëzojë më shumë kërkesa për përdorimin e mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013, me kusht që të mos kalojë shumën e përgjithshme maksimale të shpenzimeve të pranueshme për financim dhe përderisa projektet e kaluara kanë pasur përfundim të suksesshëm, gjegjësisht përkrahja financiare tërësisht është paguar.</p>
6.	<p>Shpenzimet e pranueshme të përgjithshme</p>
	<p>Shpenzimet e pranueshme për ko-financim kanë të bëjnë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) ndërtim ose rindërtim të objekteve b) furnizim të mbjelljeve shumëvjeçare c) furnizim të makinave dhe pajisjeve të reja, duke i inkuadruar softuerët kompjuterik në shumë të vlerës së tregut të mjeteve ç) shpenzime të përgjithshme të lidhura me shpenzime të pranueshme të dhëna në pikat a), b), dhe c) siç janë arkitektë, inxhinierë dhe shpenzime të tjera konsultative, fizibiliti studime (studime të realizueshmërisë), fitimin e të drejtave dhe licencave në shumë maksimale prej 12% nga shpenzimet e pranueshme të përgjithshme të dhëna në pikat a), b), dhe c) dhe janë në pajtueshmëri me kushtet në vijim: <ul style="list-style-type: none"> - për projektet me gjithsej shpenzime të pranueshme të investimeve të dhëna në pikat a), b) dhe c) mes 1.000.000 eurove ose në kundërvlerë prej 61.505.500,00 denarëve dhe 3.000.000 eurove ose në kundërvlerë prej 184.516.500,00 denarë, shpenzimet e përpilimit të planit të punës nuk mund të jenë më të mëdha se 5% nga shpenzimet e pranueshme të këtyre investimeve, dhe - për projektet me gjithsej shpenzime të pranueshme të investimeve të dhëna në pikat a), b) dhe c) më të vogla se 1.000.000 euro ose në kundërvlerë prej 61.505.500,00 denarëve, shpenzimet për përpunimin e përpilimin e planit të punës nuk mund të jenë më të mëdha se 5% nga shpenzimet e arsyeshme të këtyre investimeve dhe <p><u>Shpenzimet e pranueshme specifike sipas llojeve të investimeve janë të dhëna detajisht për secilën masë posaçërisht dhe lloj të investimit në Udhëzimin për përdoruesit e mjeteve sipas IPARD Programit 2007-2013.</u></p> <p>Shpenzimet e pranueshme të kofinancimit duhet të jenë nga vendet anëtare të Bashkësisë Evropiane, vendet kandidatë për anëtarësim në Bashkësinë Evropiane, vendet kandidat potencial për anëtarësim në Bashkësinë Evropiane dhe vendet shfrytëzues të instrumentit "Fqinjësi dhe partneritet evropian" dhe vende të tjera të cilat kanë qasje reciproke në ndihmën e jashtme të Bashkësisë Evropiane. Lista e këtyre vendeve është e dhënë në <i>Udhëzimin për shfrytëzuesit të mjeteve sipas IPARD Programit 2007-2013</i></p>
7.	<p>Shpenzimet e papranueshme</p>
	<p>Shpenzimet në vijim nuk janë të pranueshme për ko-financim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - tatime, duke inkuadruar edhe tatimin e vlerës së shtuar; - tatime doganore dhe tatime tjera importi, ose tatime tjera; - blerje, huamarrje ose qira të tokës dhe objekteve ekzistuese, pavarësisht nga ajo nëse qiraja do të sjellë deri te transferimi i pronësisë së qiramarrësit; - dënime, dënime financiare dhe shpenzime nga kontestet gjyqësore;



	<ul style="list-style-type: none"> - shpenzime operative; - pajisje dhe makina të përdorura; - tatime bankare, shpenzime për garanci dhe tatime të ngjashme; - shpenzime për konvertim (kthim), të dhëna dhe humbje nga kursi devizor të lidhur me llogarinë në euro të IPARD, si dhe vetëm shpenzime tjera financiare; - kontribute në natyrë; - blerje të të drejtave për prodhime bujqësore, blegtori, bimë vjetore dhe kultivimin e tyre; - çfarëdo mirëmbajtje, amortizim dhe shpenzime për qira; - shpenzime të administratës publike në udhëheqjen dhe zbatimin e ndihmës, pikërisht të atyre në strukturën operative dhe, posaçërisht shpenzimet e regjisë, qiratë dhe rogat e personelit të angazhuar për aktivitete të udhëheqjes, aplikimit, përcjelljes së kontrollit.
8.	Llogaritja e kursit të euros
	Shumat e shprehura në euro llogariten në kundërvlerë denarë sipas kursit të mesëm të euros të vërtetuar nga Banka qendrore evropiane. Për muajin shkurt 2011, kursi i euros është 61.505.500,00 denarë për 1 euro (www.ec.europa.eu/budget/infocuro).
9.	Afati për realizimin e investimit
	Perioda e pranueshme për realizimin e secilit investim është më së shumti 24 muaj nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes për përdorim të mjeteve.
10.	Kriteret dhe kushtet e përgjithshme për shfrytëzim
	<p>Kërkuesi duhet të mbushë dhe dorëzojë Kërkesë për shfrytëzim të mjeteve sipas masës përkatëse si dhe:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. plan afarist, me të cilin tregohet qëndrueshmëria/llogaria ekonomike dhe mundësia për punësime të reja i cili përpilohet në pajtim me <i>Udhëzimin për përpilimin e planit afarist;</i> 2. dokumentacion për procedurë të kryer për mbledhjen e të paktën tre ofertave nga ofrues të ndryshëm të pavarur me specifikimet teknike dhe vendin e prejardhjes për secilin furnizim, mall dhe shërbim veç e veç, si dhe deklarata nga ana e prodhuesit për vendin e prejardhjes së prodhimeve të ofruara, përderisa vlera e përcaktimit individual paraqet shumën më tepër se 10.000 euro, ose në kundërvlerë prej 615.055,00 denarë, gjegjësisht një ofertë nga një ofrues i pavarur me specifikimet teknike dhe vend të prejardhjes për secilin furnizim individual të mallrave dhe shërbimeve si dhe deklarata të prodhuesit për vendin e prejardhjes së prodhimeve të ofruara , përderisa vlera është nën 10.000 euro ose në kundërvlerë prej 615.055,00 denarë. Ofertat duhet të jenë të mbledhura nga persona me të cilët kërkuesi nuk ka lidhje personale dhe farefisnore dhe/ose furnizues që nuk kanë marrëdhënie mes veti në lidhje me pronën. 3. dëshmi për pagimin e tatimeve, në bazë të tatimeve dhe kontributeve ndaj shtetit në bazë të sigurimit shëndetësor, pensional dhe social, 4. dëshmi për pagimin e detyrimeve ndaj Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave në bazë të marrëveshjes (vetëm për kërkuesit për masën 101 dhe masën 103), 5. dëshmi për sigurimin e mjeteve financiare për realizimin e investimit (vetëm për kërkuesit për masën 103), 6. dëshmi se është pronar i tokës bujqësore ose ka marrëveshje për qira ose të drejtë për shfrytëzim të tokës bujqësore për më së paku 5 vjet gjegjësisht 10 vjet në rast kur investimet kanë të bëjnë me përtëritjen e të mbjellave shumëvjeçare ose vërtetim të sistemit të ujitjes. 7. dëshmi se është pronar i një objekti ose ka marrëveshje për qira ose të drejtë shfrytëzimi të objektit për më së paku 5 vjet gjegjësisht 10 vjet në rast kur investimet kanë të bëjnë edhe me punët ndërtimore. Në rast të ndërtimit të një objekti të ri, duhet të dorëzohet dëshmi për pronësi apo të drejtë për shfrytëzim të tokës për ndërtim,



	<p>8. të përgatit dhe dorëzojë dokumentacion teknik projektues së bashku me planet për ndërtim/rindërtim në qoftë se investimi përfshin edhe punët ndërtimore, dhe dëshmi që projekti i plotëson standardet ndërtimore të Komunës dhe standardet tjera në pajtim me planet urbanistike ose hapësinore</p> <p>9. dëshmi për shpenzimet e përgjithshme të bëra dhe shpenzimet për përpilimin e planit afarist të bëra pas 01.01.2007,</p> <p>10. dëshmi për pajtueshmëri të investimit me Strategjinë për zhvillim lokal të komunës në të cilën gjendet investimi. Përderisa komuna ende nuk e ka aprovuar Strategjinë për zhvillim lokal në kohën e dorëzimit të kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve, kërkuesi në planin afarist bashkëngjijt analizën e kontributit të investimit për zhvillimin ekonomik lokal në komunën në të cilën gjendet investimi dhe</p> <p>11. mendim nga trup profesional përkatës për përmbushjen e ligjeve relevante nacionale dhe standardeve relevante të Bashkimit Evropian në lidhje me investimet.</p> <p>Investimet duhet ti plotësojnë standardet minimale nacionale për mbrojtje të ambientit jetësor, shëndetësisë publike, shëndetin e kafshëve dhe bimëve, begatinë e kafshëve dhe mbrojtja gjatë punës deri në momentin kur të silltet vendim për aprovim të përkrahjes financiare .</p> <p>Në rast kur standardet nacionale minimale të cilat janë në pajtim me standardet e Bashkimit Evropian, janë zbatime të reja në periudhën kur kërkesa për përkrahje financiare është dorëzuar, përkrahja mund të ndahet pa dallim të papërshtatshmërisë me standardet por me kusht që zbatimet e reja të standardeve të arrihen me realizimin e investimit.</p> <p>Dokumentet të cilat jepen në bazë të librave publik ose sistemit institucional të evidentimit nuk duhet të jenë më të vjetër se tre muaj nga dita e publikimit në shpalljen publike.</p> <p>Në pajtueshmëri me Rregullimin për mënyrën dhe procesin e përdorimit të përkrahjes financiare për masat e zhvillimit rural të financuara nga ana e Komponentit V – IPARD nga instrumenti për ndihmë para anëtarësisë IPA (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 112/09) dokumentet të cilat dorëzohen në mbështetje të kërkesës për përdorimin e mjeteve duhet të jenë në origjinal në gjuhën maqedonase ose kopje të vulosur në noter, nëse nuk është e përcaktuar ndryshe. Nëse dokumentacioni është në gjuhë tjetër e njëjta duhet të jetë e shoqëruar me përkthim në gjuhën maqedonase e vulosur nga përkthyes zyrtar, mirëpo nëse bëhet fjalë për dokument zyrtar të një shteti tjetër atëherë duhet të jetë e verifikuar me apostil</p> <p>Informata më të detajuara për kërkesa specifike për pranueshmëri janë të shprehura në <i>Udhëzim për shfrytëzuesit e mjeteve sipas IPARD Programit 2007-2013.</i></p>
11.	<p>Procedura para Agjencisë</p> <p>1. Procedura e Agjencisë prej pranimit të Kërkesave deri në realizimin e marrëveshjes për shfrytëzimin e mjeteve përbëhet nga:</p> <p>1. Kontroll të kompletimit të dokumenteve të dorëzuara në pajtueshmëri me dokumentet e kërkuara sipas masave dhe llojeve të investimeve dhe atë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nëse dokumentet janë të dhëna nga institucionet përkatëse; • Nëse dokumentet i posedojnë të gjitha elementet me të cilat dëshmojnë se janë të besueshme (vulë, nënshkrim të personit përgjegjës, datë etj.) • Nëse dokumentet janë me afat të vazhdimt i cili është i cekur në <i>Kërkesën për shfrytëzimin e mjeteve;</i> <p>Kërkuesi duhet të kryejë plotësim të kërkesave të paplotësuara për shfrytëzimin e mjeteve në bazë të lajmërimit të fituar me shkrim nga ana e Agjencisë. Afati për plotësimin e kërkesave të paplotësuara nuk mund të jetë më i shkurt se 8 ditë.</p> <p>2. Kontroll të përshtatshmërisë së kërkesës për shfrytëzim të mjeteve bëhet me qëllim që të vërtetohet:</p>



	<ul style="list-style-type: none"> • Nëse dokumentet e dorëzuara argumentojnë plotësim të kriterëve dhe kushteve për pranueshmëri të aktiviteteve të propozuara investuese; • Nëse investimi i propozuar është ekonomikisht dhe financiarisht i realizueshëm dhe i përmbajtur, i cili kontrollohet përmes analizës së parametrave të përmbajtur në planin e bashkëngjitur afarist; • Nëse investimi i propozuar për të cilin kërkohet përkrahje financiare nuk është i financuar nga burime të tjera publike të mjeteve (Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe donatorët ndërkombëtar); • Nëse çmimet e aktiviteteve të propozuara investuese janë në kuadër të çmimeve të tregut përmes analizës së çmimeve referente për aktivitete përkatëse. <p>Me qëllim të vërtetimit të autenticitetit të parametrave teknik, të dhënave ekonomike dhe financiare, Agjencia ka të drejtë të kërkojë dokumente dhe informata shtesë si bazë për sjelljen e vendimit.</p> <p>Verifikimin e besueshmërisë së të dhënave në Kërkesën për shfrytëzim të mjeteve e kryejnë persona të autorizuar të Agjencisë me kontrollim në vendin e ngjarjes.</p> <p>Rangimi u bëhet të gjitha kërkesave të kompletuara dhe të përshtatshme për shfrytëzimin e mjeteve në pajtueshmëri me tabelat e paraqitura për rangim sipas masave më të veçuara.</p> <p>Përkrahja financiare do të aprovohet për të gjitha kërkesat e kompletuara dhe të përshtatshme për shfrytëzimin e mjeteve në kuadër të mjeteve në dispozicion sipas masës në bazë të kontrollimit administrativ të bërë në vend të ngjarjes.</p> <p>Kërkesat e pakompletuara dhe jo përkatës, si dhe kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve të cilët kanë numër më të vogël të pikëve në lidhje me mjetet në dispozicion sipas masës, do të jenë të refuzuara me Vendim.</p> <p>Me kërkuesin, kërkesa e të cilit për shfrytëzim të mjeteve është e refuzuar, nënshkruhet Marrëveshje në afat prej 30 ditëve nga dita e marrjes së Vendimit për aprovim të mjeteve nga IPARD Programi.</p> <p>Kërkuesit nuk guxojnë të fillojnë me realizimin e investimeve para nënshkrimit të Marrëveshjes për shfrytëzim të mjeteve me Agjencinë, në përjashtim të aktiviteteve të lidhura me shpenzimet e përgjithshme (përpilimin e planit afarist, fizibili studimit (studimit të realizueshmërisë), arkitektët, dokumentacioni për projekte).</p> <p>Pas mbarimit të investimit, kërkuesi është i detyruar të dorëzojë në Agjenci kërkesë për pagesë në afatin e vërtetuar në Marrëveshje për shfrytëzimin e mjeteve.</p> <p>Kërkuesi i cili do të nënshkruajë marrëveshje me Agjencinë është i obliguar që investimin që është lëndë e marrëveshjes mos ta huazojë, mos ta japë me qira, mos t'ia ndërrojë synimin dhe lokacionin e të njëjtës gjatë tërë kohës së marrëveshjes gjegjësisht 5 vjet nga pagesa e fundit të mjeteve financiare.</p> <p>Kontrollim në vend të ngjarjes dhe aplikim të mbikëqyrjes ndaj marrëveshjes bëjnë persona të autorizuar nga institucionet relevante të Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian.</p> <p>Në pajtim me Ligjin për themelimin e Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural,(Gaz. Zyrtare e RM" nr. 72/07, 5/09), Agjencia vendos në lidhje me kërkesën e dorëzuar për shfrytëzimin e mjeteve gjegjësisht kërkesë për pagim më së voni në afat prej tre muajve nga dita e mbarimit të afatit për dorëzim të kërkesës për përdorim të mjeteve, gjegjësisht të Thirrjes publike për dorëzim të kërkesave për shfrytëzim të mjeteve dhe tre muaj nga dita e pranimit të kërkesës për pagim.</p> <p>Kërkesat për shfrytëzim të mjeteve, si dhe dokumentet e bashkëngjitura nuk kthehen.</p>
12.	Kriteret për zgjedhje të përdoruesve
12.1.	Kriteret për rangim të kërkesave sipas masës 101 Kërkesat të cilat i plotësojnë kushtet për shfrytëzimin e përkrahjes financiare për masën 101 rangohen me pika në këtë mënyrë:



	Qëllimet e masës	TREGUES	Pikat në rast të përmbushjes	Maks.
1	Përkrahja e shoqatave të zejtarëve dhe aktiviteteve zejtare	Përderisa investimi është propozuar nga ana e bujqve individual, të cilët janë anëtarë të kooperativës bujqësore ose shoqatave të bujqve	35	35
		Përderisa investimi është e propozuar nga kooperativa bujqësore	30	
		Përderisa investimi është e propozuar nga persona juridik të përcaktuar nga shoqatat e bujqve	25	
2	Përparimi i mbrojtjes së rrethinës	Përderisa investimi është i orientuar drejt vendosjes së sistemit për kursim të energjisë dhe kursimit të ujit në ekonominë bujqësore, si dhe përparim të praktikave bujqësore për mbrojtje të ambientit jetësor	25	25
3	Përmirësim të strukturës gjinore dhe moshës në hapësirat rurale	Përderisa bartës të ekonomisë bujqësore për të cilën është e dhënë investimi është grua	15	30
		Përderisa investimi është i propozuar nga ana e bujqve të rinj (mes moshës 18 dhe 40)	15	
4	Orientimi tregtar i prodhimit bujqësor	Përderisa dorëzimi i prodhimit primar të prodhuar në ekonominë bujqësore në rrjetin e tregut për ushqim është në bazë të rrugës së marrëdhënieve të marrëveshjes	10	10
			GJITHSEJ	100

12.2.

Kriteret për rangim të kërkesave sipas masës 103



Instrument për ndihmë parashyrtë të Bashkimi Evropian
për zhvillim rural për 2007-2013



Kërkesat të cilat i përmbushin kushtet për përdorim të përkrahjes financiare për masën 103 janë të ranguar në këtë mënyrë:

	Qëllimet e masës	TREGUES	Pikat në rast të përmbushjes	Maks. pikë
1	Qëllimi i projektit	Përderisa investimi është për qëllim të modernizimit dhe përkryerjes teknologjike të ndërmarrjeve ekzistuese gjatë kohës së mbylljes së ndërmarrjeve të vjetra	30	30
		Përderisa investimet kanë për qëllim hapjen e qendrave për mbledhjen e pemëve dhe perimeve të freskëta dhe qumështit të papërpunuar ose thertoreve për kafshë.	25	
		Përderisa investimet kanë për qëllim modernizimin dhe përsosshmërinë teknologjike të ndërmarrjeve ekzistuese me qëllim të rritjes së kualitetit të prodhimit.	20	
2	Mbrojtja e ambientit jetësor	Përderisa investimet kanë për qëllim zvogëlimin e ndikimit negativ ndaj ambientit jetësor përmes pastrimit të ujit	15	30
		Përderisa investimet kanë për qëllim pastrimin e mbeturinave dhe riciklimin në kohën e valorizimit të nus prodhimeve	15	
3	Kontroll i përmirësuar i kualitetit të prodhimeve	Përderisa investimet kanë për qëllim hapjen e laboratorëve ose modernizim të atyre ekzistues	15	25
		Përderisa investimet kanë për qëllim pajisjet për mbikëqyrje të kualitetit, sistemeve për kontrollim dhe përcjellje	10	
4	Marrëdhënie të kontraktuara me prodhues individual bujqësor	Përderisa investimi ka të bëjë me modernizimin e ndërmarrjeve ekzistuese, ndërsa furnizimet personale dhe marrëdhëniet e kontraktuara me prodhues bujqësor individual përfshijnë më së paku 50% të furnizimeve dhe kanë të bëjnë me periudhën prej më pak se një vjet	15	15
		Përderisa bëhet fjalë për investime të reja, ndërsa furnizimet personale dhe marrëdhëniet kontraktuese me prodhuesit bujqësor individual përfshijnë më së paku 50% të furnizimeve të lëndëve të para për periudhën prej më pak se një vit pas përfundimit të projektit.	10	
			GJITHSEJ	100



	Qëllimet e masës	TREGUES	Pikat në rast të përmbushjes	Maks. pikë
1	Qëllimi i projektit	Përderisa shfrytëzuesi është kompani për përpunimin e mishit	40	40
		Përderisa shfrytëzuesi është thertore	30	
2	Mbrojtje të ambientit jetësor	Përderisa shfrytëzuesi ka lidhje me kanalizimin publik	30	30
		Përderisa shfrytëzuesi përdor gropa për ujëra të zeza si sistem e kanalizimit	20	
3	Ndihmë për gra dhe operatorë të rinj ekonomik	Përderisa personi përgjegjës tek personi juridik është grua	15	30
		Përderisa investimi është propozuar nga operatorë të ri ekonomik të moshës prej 18 deri 40 vjet	15	
			GJITHSEJ	100

12.3.

Kritere për rangim të kërkesave sipas masës 302

Kërkesat të cilat i përmbushin kushtet për shfrytëzim të përkrahjes financiare për masën 302 rangohen me pika në këtë mënyrë:

	Qëllimet e masës	TREGUES	Pikat në rast të përmbushjes	Maks. pikë
1	Lokacioni i projektit	Përderisa investimi është i vendosur në komunat me qendra rurale, vendbanime malore dhe kodrinore, zona kufitare, zona të pazhvilluara ekonomike ose specifike	15	35
		Përderisa investimi është i vendosur në komunë e cila gjendet në afërsi të zonës së mbrojtur në pajtim me Ligjin për mbrojtje të natyrës (Gazeta Zyrtare e RM nr. 67/04, 14/06, 84/07, 35/10)	10	
		Përderisa investimi është i vendosur në komunën e cila është e afërt me trashëgiminë kulturore ose gjetjet arkeologjike e cila është e emëruar në pajtim me Ligjin për mbrojtje të trashëgimisë kulturore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 20/04, 115/07)	10	



	2	Krijim i mundësive për punësim	Përderisa investimi parasheh mundësi për punësim të më së paku 5 ndërsa më së shumti 10 personave	15	15
			Përderisa investimi parasheh mundësi për më së paku tre punësime të reja	10	
			Përderisa investimi parasheh mundësi për më së paku një punësimi të ri	5	
	3	Mbrojtje e traditës dhe trashëgimisë	Përderisa investimet i respektojnë cilësitë tradicionale nga hapësirat rurale atje ku janë të vendosura (pamje tradicionale e ndërtimeve të jashtme dhe të brendshme, recetat tradicionale, kuzhinë, zejtari etj.)	20	20
	4	Promovim i veprimtarive bashkëpunuese	Përderisa bëhet fjalë për projekte të përbashkëta të cilat kyçin partneritete private mes operatorëve të ndryshëm ekonomik rural	10	10
5	Përmirësimi i strukturës gjinore dhe moshës në hapësirat rurale	Përderisa personi përgjegjës ndaj personit ligjor është grua gjegjësisht udhëheqës i ekonomisë bujqësore për të cilën dërgohet investimi është grua	10	20	
		Përderisa investimi është i promovuar nga persona të moshës prej 18 deri 40 vjet	10		
			GJITHSEJ	100	

